



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Metoda dhe Metodologji të Mësimdhënies së Gjuhës së Huaj

Ngarkesa: 5 kredite; 50 orë mësimore; 40 leksione / 10 seminare

Viti / Semestri : Viti I ,semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e gjuhës italiane për arsimin e mesëm të lartë”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Lënda synon të zgjerojë dhe të thellojë njohuritë e marra në lidhje me metodat dhe qasjet në mësimdhënien e gjuhës së huaj për një formim sa më të specializuar profesional të mësuesit të ardhshëm mbi specifikat, karakteristikat, avantazhet dhe disavantazhet që paraqet secila metodë e qasje. Kjo lëndë bën të mundur që mësuesi i ardhshëm jo vetëm t’i njohë ato dhe të bëjë dallimin ndërmjet tyre por, dhe e aftëson atë që të shquajë se cilat janë vlerat që paraqet secila prej tyre me qëllimin aplikimin e tyre në klasë në të ardhmen. Gjithashtu lënda i ofron mësuesit të ardhshëm analizimin e tekstit të gjuhës/ manualit e metodave përkatëse, ndërtimi i njësisë didaktike për fasha të ndryshme moshore dhe sipas nevoja të studentit, përdorimin e materialit autentik në realizimin didaktik të tij si dhe testimin dhe vlerësimin e gjuhës së huaj.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Studenti analizon në mënyrë krahasuese zhvillimin historik të qasjeve dhe metodave të mësimdhënies së gjuhëve të huaja, duke identifikuar faktorët ndikues, përfaqësuesit kryesorë dhe veçoritë e tyre gjuhësore, didaktike dhe psikologjike.
- 2.Studenti demonstroi aftësi për të interpretuar dhe zbatuar në praktikë teori dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies (si ludike, andragogjike, cooperative learning), duke kuptuar kontekstin teorik dhe teknikat përkatëse që i karakterizojnë.
- 3.Studenti është në gjendje të projektojë dhe të realizojë një orë mësimore sipas metodave të ndryshme, duke menaxhuar ndërveprimin në klasë, duke njohur rolin e gabimit në procesin e të nxënësit dhe duke integruar risitë didaktike të epokave të ndryshme.

Rezultatet e pritshme:

- 1.Studenti demonstroi aftësi për të analizuar, krahasuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike metodat dhe qasjet e ndryshme të mësimdhënies së gjuhës së huaj, duke identifikuar zbatueshmërinë e tyre sipas kontekstit mësimor, moshës dhe nevojave të nxënësit.
- 2.Studenti është në gjendje të hartojë dhe të realizojë një njësi didaktike duke përdorur materiale autentike, teknika të përshtatshme dhe strategji të vlerësimit, në përputhje me metodën e zgjedhur dhe qëllimet e orës mësimore.